

Kontratë

Për shërbime bankare për tërheqjen në faza të kontributeve pensionale

Lidhur në mes të:

Autoriteti Kontraktues: Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, më tej referuar si Autoriteti Kontraktues (shkurtesa: AK)

Ofruesi i shërbimeve: Banka Kombëtare Tregtare sh.a., me numër licence 009. I datës 14.09.2018; meme numër unik identifikues të biznesit 810543399 dhe me numër fiskal 600120133, përfaqësuar nga Suat Bakkal, më tej referuar si "ofruesi i shërbimeve"

Të dy palët kontraktuese më tej të referuara si "Palët"

Neni 1: Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është rregullimi i të drejtave dhe obligimeve të Autoritetit Kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, lidhur me implementimin e shërbimeve bankare për tërheqjen në faza të kontributeve pensionale, në përputhje me kushtet dhe afatet e parapara në këtë kontratë, e lidhur pas Vendimit të datës 24.06.2021 të Bordit të FKPK.

Neni 2: Kohëzgjatja e kontratës

2.1 Kjo kontratë hyn në fuqi me datë 01/10/2021 dhe vlen deri me datë 30/09/2024

2.2 Kushtet dhe afatet e kësaj kontrate do të mbesin në fuqi, për të gjitha llogaritë e Kryegjësë me bilanc pozitiv, edhe kur kjo kontratë skadon.

2.3 Palët, në rast të ndërprerjes së parakohshme të kontratës, obligohen ta njoftojnë me shkrim njëra-tjetrën së paku 90 ditë më parë.

Neni 3: Çmimi

3.1 Palët janë pajtuar që për shërbimet e ofruara nga Ofruesi i Shërbimeve, të aplikohen çmimet e përcaktuara me këtë kontratë.

3.2 Përgjatë kohës që kjo kontratë është në fuqi, Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë të bëjë ndryshime të çmimeve për shërbimet e ofruara, të cilat janë objekt i kësaj kontrate.

Neni 4: Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

4.1 Ofruesi i Shërbimeve, obligohet të hapë llogari të Kryegjësë për secilin person të pensionuar, që paraqitet në zyret e Ofruesit të Shërbimeve, e i cili i plotëson kushtet e parapara nga Ofruesi i Shërbimeve për hapje të llogarive, dhe të njëjtat t'i kreditojë me shumat relevante, në ditën e fundit të punës së çdo muaji.

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS	
KOSOVSKI PENZIJSKI ŠTEDNI FOND	
KOSOVO PENSION SAVINGS TRUST	
DORËZUAR KËRORUÇENA DELIVERED	<input type="checkbox"/>
PRANUAR PRIMLIJENO RECEIVED	<input checked="" type="checkbox"/>
DATA: 02.09.2021	
M. PR. 2021/0529 2-03 005	

Handwritten signatures and initials in blue ink.

4.2 Me të hapur Llogarinë e re të Kryegjësë, Ofruesi i Shërbimeve do t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues, të dhënat vijuese: *Numrin Personal, Llogarinë e Kryegjësë* (Llogaria në të cilën mbahet shuma totale e mjeteve që i takojnë të pensionuarit), *Llogarinë e Pagesës* (nëse ndryshon nga ajo e kryegjësë), në të cilën bëhet pagesa mujore për të pensionuarin, në përputhje me udhëzimet e AK.

4.3 Ofruesi i Shërbimeve do të paguajë ose do të vejë në dispozicion shumën për pagesë, në Llogarinë e Pagesës, jo më larg se ditën e dytë të punës të secilit muaj, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga AK, deri sa Bilanci i Kryegjësë të arrijë shumën zero (0).

4.4 Kamata do të përlllogaritet në baza ditore dhe do të paguhet në Llogarinë e Kryegjësë në bazë mujore, në ditën e fundit të secilit muaj, bazuar në Bilancin e Kryegjësë në çdo ditë të muajit. Kamata do të jetë kombinim (EURIBOR 6-mujor +0%) ose 1.5% vjetore, cilado që të jetë me e lartë. Nëse duhet të përdoret kombinimi për llogaritjen fillesatre do të merren për bazë EURIBOR-i i datës së transferit të parë nga Autoriteti Kontraktues, kurse për periudhat tjera EURIBOR-i do të ndërrojë me datat 1 janar (me EURIBOR-in e ditës paraprake) dhe 1 korrik (me EURIBOR-in e ditës paraprake) të çdo viti deri në shterimin e bilancit në secilën llogari. Kjo mënyrë e llogaritjes do të aplikohet për të gjitha llogaritë me këtë kontratë.

4.5 Ofruesi i Shërbimeve, është i obliguar që secilin të pensionuar, i cili hap llogari të pagesës, ta pajisë me kartelën e debitit (me të cilën do të mund të bëjë tërheqjen e mjeteve nga ATM)

4.6 Ofruesi i Shërbimeve është i obliguar që brenda 90 ditësh nga nënshkrimi i kësaj kontrate, ta përshtasë sistemin e TI-së, në mënyrë që të jetë i gatshëm për ofrimin e Shërbimit të Tërheqjes në Faza.

4.7 Ofruesi i Shërbimeve është i obliguar që për secilën pagesë mujore të ekzekutuar në llogarinë e pagesës, t'i zbresë të gjitha tatimet e aplikueshme në të ardhurat personale të parapara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

4.8 Ofruesi i shërbimeve obligohet që t'i dërgojë AK raportin mujor për Bilancin e Llogarive të Kryegjësë, Debitimin/Kreditimin dhe Normën e aplikuar të Kamatës.

4.9 Në rast të vdekjes së Pensionistit, para se Bilanci në Llogarinë e Kryegjësë të arrijë shumën zero (0), Ofruesi i Shërbimeve obligohet që, në përputhje me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, pagesat mujore t'i transferojë te trashëgimtari/trashëgimtarët e tij.

4.10 Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ngarkojë komision për hapjen e Llogarisë së Kryegjësë ose Llogarisë së Pagesës, e as për mirëmbajtjen e Llogarive, ose për kreditimin e Llogarisë së Pagesës me pagesën në rastet kur Llogaria e pagesës është e hapur te Ofruesi i Shërbimeve.

4.11 Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ngarkojë kurrfarë komisionesh për tërheqjen nga Llogaria e Pagesës më të larta se komisionet standarde, që ngarkohen nga Ofruesi i Shërbimeve për tërheqje të tilla.



4.12 Ofruesi i Shërbimeve obligohet që me kërkesë të AK të ofrojë informata mbi detajet e Llogarisë së Pagesës.

4.13 Ofruesi i Shërbimeve mund të ngarkojë tarifa standarde për transferimin e pagesës mujore në Llogari të pagesës e cila nuk është e hapur tek Ofruesi i Shërbimeve, me ç'rast pagesa që arrin në Llogarinë e Pagesës zvogëlohet.

4.14 Pensionisti ose trashëguesit e tij/saj nuk do të ngarkohen me ndonjë tarifë për lëshimin fillestar të debit kartelës (me të cilën mund të bëhet tërheqja e mjeteve në ATM), e as për lëshimet e mëvonshme të kartelave të skaduara apo për mirëmbajtjen e tyre.

4.15 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas Ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës, në veçanti sipas Ligjit 04/L-101 për Fondet Pensionale me të gjitha plotësimet dhe ndryshimet e veta, si dhe Rregulloreve të BQK-së për Pensione, si dhe të marrë masat e nevojshme që personeli i tij të veprojë sipas këtyre Ligjeve dhe Rregulloreve. Ofruesi i Shërbimeve do ta sigurojë AK nga të gjitha ankesat dhe kontestet eventuale që mund të shfaqen si pasojë e mos respektimit të dispozitave ligjore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve, punëtorëve të tij dhe vartësve të tyre.

4.16 Ofruesi i Shërbimeve për të gjithë pjesëmarrësit në programin e tërheqjes në fazë, të cilët ende nuk i kanë shterur Llogaritë e tyre të Kryegjësë, duhet të vazhdojë me aplikimin e të gjitha detyrave, përgjegjësi dhe kushteve të kësaj kontrate, edhe pas skadimit të saj.

4.17 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha humbjet dhe kërkesat lidhur me aktivitetet e shërbimeve, në rast se vërtetohet se ka vepruar në kundërshtim me kushtet dhe afatet e kësaj kontrate.

Neni 5: Obligimet e Autoritetit Kontraktues

5.1 Autoriteti Kontraktues obligohet që me kohë, t'i sigurojë Ofruesit të Shërbimeve informatat dhe/apo dokumentet që ka në dispozicion, e të cilat mund të jenë relevante për realizimin e kontratës.

5.2 Autoriteti Kontraktues obligohet që , t'i dërgojë Ofruesit të Shërbimeve të gjitha informatat që kanë të bëjnë me transferet dhe të cilat duhet të përmbajnë, për secilin të pensionuar, të dhënat si: *emri, mbiemri, numri personal, data e lindjes, adresa, shuma e Kryegjësë, pagesa mujore, llogaria e pagesës* si dhe çfarëdo informate tjetër të nevojshme për realizimin e pagesave.

5.3 Autoriteti Kontraktues është i obliguar që të japë të dhëna të sakta për procesim të pagesave në Llogarinë e Kryegjësë dhe në atë të pagesës. Sidoqoftë, AK rezervon të drejtën të kthejë prapa cilëndo shumë deri në shumën e bilancit të Llogarisë së Kryegjësë, e cila përcaktohet nga AK t'i jetë atribuar gabimisht Pensionistit, pa asnjë kosto përveç koston së transferimit të fondeve të këtilla në Llogarinë e AK në BQK.

5.5 Autoriteti Kontraktues është i obliguar që, në rastet kur ndryshon pagesën mujore të një apo më shumë pjesëmarrësve/pensionistëve, ta njoftojë Ofruesin e Shërbimeve me paralajmërim brenda më së paku pesë (5) ditëve.

314 

Neni 6: Nën-kontraktimi

6.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar, përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Nënkontraktimi, nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mund të nënkontrakttojë, pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve duhet t'i bëhen të ditura Autoritetit Kontraktues. AK do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke argumentuar arsyet në rast të refuzimit.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të tij si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë sikur të ishin akte, gabime ose neglizhence e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit Kontraktues, nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga detyrimet e tij sipas kësaj kontrate.

Neni 7: Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit, nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti Kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore, sipas përkufizimit në nenin 8 të kësaj kontrate

7.2 Brenda 5 (pesë) ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Ofruesi i Shërbimeve duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës se realizimit, për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër në mes të Ofruesit të Shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Autoriteti Kontraktues, brenda 5 (pesë) ditësh nga pranimi i detajeve sipas par. 7.2. të këtij neni, do të lejojë zgjatjen e periudhës së realizimit, nëse kjo mund të arsyetohet ose në mënyrë prospective ose retrospektive, ose do ta informojë Ofruesin e Shërbimeve që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 8: Forca madhore

8.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të kontratës nëse realizimi i obligimeve që rrjedhin nga kontrata, parandalohen nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga ndonjë *forcë madhore* që ndodh pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

8.2 Termi "*forcë madhore*" nënkupton veprimet e natyrës, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet të armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokër, tërmetet, shtrëngatat,

vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet përkundër kujdesit të duhur.

8.3 Pala e prekur nga një rast i forcës madhore do t'i ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar të gjitha pamundësitë e asaj pale për t'i përmbushur obligimet e saj me një vonesë minimale.

8.4 Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet eventuale, ose për shkeljet për shkak të shkeljes së kushteve të kontratës, nëse vonesa e realizimit të tij apo ndonjë lloj tjetër dështimi në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kjo kontratë, vjen si rezultat i forcës madhore. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje për shkak të shkeljes së kontratës nga ana e tij, nëse vonesa e AK apo ndonjë lloj tjetër dështimi në përmbushje të obligimeve të tij, vjen si rezultat i forcës madhore.

8.5 Nëse ndonjера palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në përmbushjen e obligimeve të saj, pa vonesë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna të detajuara mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që mund të kenë rrethanat e paraqitura në përmbushjen e obligimeve.

Neni 9: Konfidencialiteti

9.1 Palët pajtohen se të gjitha informatat të cilat do të shkëmbehen në mes të tyre për të përmbushur obligimet që rrjedhin nga kjo kontratë, do të konsiderohen dhe trajtohen si konfidenciale dhe pronë e secilës palë kontraktuese. Palët duhet të sigurohen që informacioni konfidencial dhe i ndjeshëm të ruhet si i tillë në çdo kohë dhe të mos përdoret për asnjë qëllim tjetër përveçse atij të përmbushjes së kontratës.

9.2 Palët nuk mund të shfrytëzojnë, publikojnë, zbulojnë apo në çfarëdo mënyre t'i vënë në dispozicion tek palët e treta, informatat konfidenciale të siguruara gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate, përveç nëse kanë autorizimin paraprak me shkrim nga pala tjetër.

9.3 Obligimi i palëve për ruajtjen e informatave konfidenciale zgjatë gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së kësaj kontrate, apo ndonjë marrëveshje tjetër e vlefshme në mes tyre, e po ashtu edhe pas skadimit të tyre.

9.4 Palët janë informuar se shkelja e konfidencialitetit përbën shkelje të kontratës, dhe zbulimi i informacionit konfidencial përbën vepër penale dhe sanksionohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovë.

Neni 10: Shkelja e kontratës

10.1 Mospërmbushja e obligimeve të kontratës nga cilado palë, konsiston në shkelje të kontratës.

10.2 Në rastet e shkeljes së kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto masa dhe kompensime:

314 

- a) dëmet, dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës

Neni 11: Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues, shtatë (7) ditë pas dhënies së paralajmërimit me shkrim Ofruesit të shërbimeve, mund ta ndërprejë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- a) Ofruesit të Shërbimeve i pezullohet licenca nga ana e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës;
- b) Ofruesit të Shërbimeve vendoset nën masa emergjente apo nën masat e revokimit të licencës nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
- c) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga AK, në evitimin e ndonjë neglizhence apo dështon në përmbushjen e obligimeve të veta sipas kontratës, duke ndikuar në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve.
- d) Ofruesi i Shërbimeve, pa autorizim nga AK, e bartë kontratën apo nënkontraktin shërbimet
- e) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një aktgjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfardo mjeti të cilin mund ta vërtetojë AK;
- h) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtuar një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;
- i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që pengon në përmbushje të kontratës.

11.2 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet,

11.3 Me rastin e ndërprerjes së kontratës, apo mos-përmbushjes së obligimeve të kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve pas skadimit të kontratës, AK mund të kërkojë kthimin e mjeteve nga disa apo të gjitha llogaritë e pjesëmarrësve në programin e tërheqjes me faza, të cilët ende nuk i kanë shterur llogaritë e tyre të Kryegjësë.

Neni 12: Ndërprerja e kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

12.1 Ofruesi i shërbimeve, shtatë (7) ditë pas dhënies së paralajmërimit me shkrim Autoritetit Kontraktues, mund ta ndërprejë kontratën nëse AK dështon t'i bëjë pagesën Ofruesit të Shërbimeve.

12.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së AK dhe Ofruesit të Shërbimeve.

J.H. 

12.3 Në rast të ndërprerjes së këtyllë, AK do t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve humbjet ose dëmet që mund t'i jenë shkatur.

Neni 13: Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

13.1 Dokumentet e referuara, shtojcat, apo çfarëdo dokumenti tjetër që ka lidhje me implementimin e kësaj kontrate, ka radhitjen e përparësisë si në vijim, duke filluar nga më e rëndësishmja:

- a) Kjo Kontratë
- b) Vendimi i Bordit të FKPK-së, i datës 24.06.2021
- c) Kërkesa e Ofruesit të Shërbimeve, e datës 25.05.2021

13.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën, do të konsiderohen se e qartësojnë njëra tjetrën. Në rastet e paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të merren në konsideratë sipas rendit të përparësisë së paraqitur më lart.

Neni 14: Komunikimet

14.1 Çfarëdo komunikimi në mes të palëve, në lidhje me Kontratën, do të jetë ekskluzivisht në formë të shkruar dhe çdo herë do të përmbajë: *Titullin e kontratës dhe numrin e referencës*. Komunikimet dërgohen me postë, faks, e-mail, apo dorëzohen drejtpërdrejt në dorë.

14.2 Nëse dërguesi i një komunikimi kërkon konfirmimin për pranimin e tij, kjo duhet të specifikohet në komunikim. Nëse ka afate kohore për pranimin e një komunikimi me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë konfirmimin për pranimin e të njëjtës. Në çfarëdo rasti, dërguesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për t'u siguruar që komunikimi është pranuar.

14.3 Njoftimet, kërkesat dhe komunikimet në mes palëve, përveç nëse specifikohet ndonjë adresë tjetër me shkrim, do të dërgohen tek adresat e cekura në këtë kontratë, që janë njëkohësisht personat përgjegjës për implementimin e kësaj kontrate.

Neni 15: Zgjidhja e mosmarrveshjeve dhe Ligji i Aplikueshëm

15.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet që mosmarrveshjet eventuale lidhur me zbatimin e kësaj kontrate t'i zgjidhin në mënyrë miqësore. Në rast të shfaqjes së ndonjë mosmarrveshjeje, palët, pa vonesë, duhet të lajmërojnë njëra-tjetrën me shkrim lidhur me qëndrimet e tyre dhe zgjidhjen që ata konsiderojnë të jetë më e arsyeshme.



15.2 Nëse cilado nga palët e sheh të dobishme, palët mund të takohen dhe të mundohen të zgjidhin mosmarrveshjen në mënyrë miqësore. Përiudha maksimale për arritjen e zgjidhjes në këtë mënyrë do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës.

15.3 Në rast se palët dështojnë që të zgjidhin mosmarrveshjen në mënyrë miqësore, brenda afatit të lartëcekur, atëherë secila palë mund të kërkojë zgjidhjen e kontestit duke iu drejtuar gjykatës kompetente në Republikën e Kosovës.



15.4 Kjo Kontratë do të qeveriset nga Ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

15.5 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe, në tri (3) kopje origjinale, dy (2) prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një (1) për Ofruesin e Shërbimeve.

Autoriteti Kontraktues	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës	Ofruesi i Shërbimeve	Banka Kombëtare Tregtare SH.A.
Përfaqësuesi	ADRIAN ZALLI	Përfaqësuesi	SUAT BAKKAL
Vendi	PRISHTINË	Vendi	
Data	09.09.2021	Data	
Nënshkrimi		Nënshkrimi	

Aneksi I

ANEKS KONTRATE

Referuar kontratës bazë të datës 09.09.2022, me numër të protokollit 2021/0329-2-03005 me titull "Kontratë për Shërbime bankare për tërheqjen në faza të kontributeve pensionale" lidhur në mes të:

Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), me seli në Prishtinë, Rr Agim Ramadani Nr. 182-184 (referuar si "Autoriteti Kontraktues - AK") dhe

Ofruesi i shërbimeve: Banka Kombëtare Tregtare sh.a., me numër licence 009. I datës 14.09.2018; me numër unik identifikues të biznesit 810543399 dhe me numër fiskal 600120133, përfaqësuar nga Suat Bakkal, më tej referuar si "ofruesi i shërbimeve"

Të dyjat bashkë referuar më tej si "Palët".

Neni 1 : Ndryshimet

- 1.1. Përmes kësaj aneks Kontrate, palët pajtohen Kontrata bazë të ndryshohet dhe plotësohet, dhe atë në nenin 2 të saj (Kohëzgjatja e kontratës), paragrafët: 2.1 dhe 2.3.
- 1.2. Përmes kësaj aneks kontrate, vazhdohet afati i Kontratës për Shërbime e lidhur në mes të palëve me datë 09.09.2021. Kohëzgjatja e Kontratës Bazë, vazhdohet për afat të pacaktuar.
- 1.3. Palët duhet ta njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim në rast të ndërprerjes së kontratës. Njoftimi me shkrim bëhet së paku 6 (gjashtë) muaj më parë.

Neni 2 : Vlefshmëria e Kushteve të kontratës bazë

Palët pajtohen që përveç ndryshimeve të paraqitura në nenin 1, paragrafët 1.2 dhe 1.3 të kësaj aneks kontrate, të gjitha kushtet e kontratës bazë mbeten të pandryshuara.



Neni 3 : Gjuha dhe numri i kopjeve

Kjo aneks-kontratë është hartuar në gjuhën shqipe, në tri kopje origjinale, një për ofruesin e shërbimeve dhe dy për autoritetin kontraktues, dhe e njëjta është pjesë përbërëse e Kontratës Bazë së cilës i bashkangjitet si "Aneksi I".

Nënshkruar në Prishtinë nga:

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Autoriteti Kontraktues	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës	Ofruesi i Shërbimeve	Banka Kombëtare Tregtare SH.A.
Përfaqësuesi	ADRIAN ZALLI	Përfaqësuesi	SUAT BAKKAL
Vendi	Prishtinë	Vendi	Prishtinë
Data	20.09.2024	Data	20.09.2024
Nënshkrimi		Nënshkrimi	

FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS
KOSOVSKI PENZIJSKI ŠTEDNI FOND
KOSOVO PENSION SAVINGS TRUST

DORËZUAR ISPORUČENA DELIVERED

PRANUAR PRIMLJENO RECEIVED

DATA: 26.09.2024

NR. PROT: 2024/0393/3-1-11-112



2024 09 26